



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-026
Prishtinë, më 21 mars 2018, në orën 17:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 MARS 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Kujtim Shala, Xhavit Haliti dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi dhe Valmir Klaiqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Osman Shatri.

Nga Ambasada Amerikane: Adem Gashi dhe

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Veprimet që duhet të ndërmerren ndaj deputetëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, të cilët në sallën e seancës plenare hodhën gaz lotsjellës dhe e pamundësuan vazhdimin e punimeve të seancës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se disa deputetë të GP të LVV-së, përsëri me hedhjen e gazit lotsjellës e pamundësuan vazhdimin e punimeve të seancës. Ai propozoi masat që duhet të ndërmerren ndaj atyre që hodhën gaz lotsjellës për të krijuar kushte normale për vazhdimin e seancës.

Me qëllim të krijimit të kushteve normale për vazhdimin e punimeve të seancës, Kryesia e Kuvendit njëzëri mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Ali Lajçi, Sami Kurteshi, Ismajl Kurteshi, Arbërie Nagavci, Valon Ramadani, Arbër Rexhaj dhe Shemsi Sylja, për hedhjen e gazit lotsjellës në sallën e seancave plenare më 21 mars 2018 u shqiptohet masa disiplinore ndalimi i pjesëmarrjes në vazhdimin e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës më 21 mars 2018.

2. Kërkohet nga Policia e Kosovës që, për shkaqe sigurie dhe krijimit të kushteve për punë të seancës plenare, ta kontrollojë sallën e seancave plenare të Kuvendit.

3. Deputetët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, gjatë hyrjes në sallën e seancave plenare t’i nënshtrohen kontrollit nga përgjegjësit e sigurisë në Kuvend - Policia e Kosovës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryesia vendosi që seanca e jashtëzakonshme t’i vazhdojë punimet në orën 18:15 minuta.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 17:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale